



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1. nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafin 63.1.1. nënparagrafi b) të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Kema Company" Sh.P.K. të datës 07.06.2023 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 02.06.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i rrugëve IV LLOTE" me nr. të prokurimit 616-23-269-5-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

**V E N D I M**

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Kema Company" Sh.P.K. e datës 07.06.2023 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 02.06.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i rrugëve IV LLOTE" me nr. të prokurimit 616-23-269-5-1-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "Kema Company" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Operatori ekonomik "Kema Company" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 07.06.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin të datës 02.06.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i rrugëve IV LLOTE" me nr. të prokurimit 616-23-269-5-1-1. Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim: "gjate vlersimit na u eshte bere e pa drejte per arsye se kemi qene me te lire dhe afati i garancionit ka qene maksimal dhe u eshte dhene kompanive me vlere tenderuse me te larte keshtu qe kerkkojme te rishqyrtohet tenderi ose ne te kunderten ne do ti ndjekim te gjitha dispozitat ligjore per ankesa".

Për shkak të pretendimeve si më sipër, parashtruesi konsideron se autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 59, 60 dhe 72 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik (tutje "LPP").

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit me datë 14.06.2023 ka trajtuar kërkesën e parashtruesit për rishqyrtim.

Lidhur me pretendimin e parashtruesit nga dosja e tenderit nenit 30.1 është gjetur se Kriteri i dhënies në këtë aktivitet është "Tenderi i përgjegjshëm ekonomikisht më i favorshëm i përcaktuar sipas kriterit të peshës së nën-kritereve të përshkruara Aneksin 6".

Kriteret e Dhënies	30.1	[Tenderi i përgjegjshëm ekonomikisht më i favorshëm i përcaktuar sipas kriterit të peshës së nën-kritereve të përshkruara Aneksin 6 <input checked="" type="checkbox"/>
--------------------	------	---

Për këtë arsye kjo pjesë e pretendimit të parashtruesit duke marrë parasysh dosjen e tenderit, është jorelevant për faktin se kriteri i dhënies së kontratës nuk ka qenë çmimi më i lirë por ka qenë tenderi i përgjegjshëm ekonomikisht më i favorshëm.

Sa i përket pjesës tjetër të pretendimit ku parashtruesi pretendon se është dashur të rekomandohet për kontratë për shkak të garancionit të tij, duhet theksuar se kriteret për dhënie të kontratës janë specifikuar në mënyrë shumë specifike dhe të kuptueshme në dosjen e tenderit, sikurse është evidentuar në vijim:

Kategoritë		Përshkrimi i kritereve	Pesha	Metoda e Vlerësimit
1	Çmimi	Pikët <100x60 %> për tenderin me çmimin më të ulët. Pikët e tenderit llogariten proporcionalisht	60%	$P = \frac{P_s}{P_t} \times [100x\%]$
2	Afati me i shkurt i implementimit nga data e nënshkrimit të kontratës deri ne max 90 dite	Pikët <100x 320%> për tenderin me periudhe me te shkurt te implementimit. Pikët e tenderit llogariten proporcionalisht	20%	$D = \frac{D_s}{D_t} \times [100x\%]$
3	Afati me i gjate i Periudhës Garantuese deri ne max 10 vite	Pikët <100x 20%> për tenderin me periudhe me te gjate garantuese. Pikët e tenderit llogariten proporcionalisht	20%	$G = \frac{G_t}{G_s} \times [100x\%]$
			100 %	

ku P- Pikët për tenderin, Ps= Çmimi më i ulët, Pt = çmimi i tenderit

ku D - Pikët për tenderin, Ds= piket per tenderin per periudhën me te shkurtër te dorezimit, Dt = piket per periudhën e tenderit

ku G - Pikët për tenderin, Gt= piket per tenderin per periudhën me te gjate garantuese, Gs = piket per periudhën e tenderit

Në rastin konkret fillimisht duhet cekur se të gjithë tenderët e ofertuar në këtë aktivitet të prokurimit janë vlerësuar, ekzaminuar dhe krahasuar nga një komision vlerësues profesionist, të pavarur, objektiv dhe në përputhje të plotë me LPP dhe legjislacionin sekondar në fuqi. Përndryshe përbërja por as puna e komisioni nuk kontestohet as nga vet parashtruesi. Sidoqoftë vlerësimi i tenderëve është bërë duke marrë parasysh të gjitha kriteret e dhënies së kontratës dhe jo vetëm një të prej tyre sikurse aludohet nga parashtruesi. Metoda e vlerësimit është përcaktuar paraprakisht në dosjen e tenderit dhe kjo metodë është respektuar më përpikmëri nga komisioni vlerësues (as ky fakt nuk kontestohet nga parashtruesi). Në anën tjetër parashtruesi nuk ka paraqitur asnjë argument, dëshmi apo provë me të cilin do të mbështetej pretendimi se komisioni ka gabuar në përllogaritjen e pikëve për tenderuesit që kanë ofertuar. Rrjedhimisht pretendimi i parashtruesit është i pabazuar në tërësi.

Sipas trajtimit dhe elaborimeve më lartë në këtë vendim është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Njëkohësisht nga provat materiale të administruara është gjetur se pretendimet e parashtruesit janë tërësisht të pabazuara. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Prishtinë, 14.06.2023**



Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Kombinuar Prishtinë

**Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.